



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.2 e datës 15 shkurt 2018 i riformuluar me dispozitat e nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20 e datës 16 gusht 2023 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_, të miratojë këtë :

### PROPOZIM

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E SHKALLËVE TATIMORE PROGRESIVE NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2025

### Neni 1 Normat Tatimore

1. Në zbatim të nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.2 e datës 15 shkurt 2018 i riformuluar me dispozitat e nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20 e datës 16 gusht 2023, Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit . Përkitazi me këtë Kuvendi i Komunës së Lipjanit cakton shkallët tatimore progresive për vitin 2025 për vlerat e pronave që llogariten sipas kufijve në vijim:
  - 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro caktohet shkalla tatimore në lartësinë prej 0.10 %;

- 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro caktohet shkalla tatimore në lartësinë prej 0.20%, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni, caktohet;
- 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro caktohet shkalla tatimore në lartësinë prej 0.30 %, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
- 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro caktohet shkalla tatimore në lartësinë prej 0.40 %, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni dhe
- 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro caktohet shkalla tatimore në lartësinë prej 0.50 %, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

**Neni 2**  
**Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa –Sektori për Tatim në Pronë.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës dhe fillon të zbatohet nga 1 janari 2025.

**Arsyetim**

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.2 e datës 15 shkurt 2018 i riformuluar me dispozitat e nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20 e datës 16 gusht 2023 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2021.

Me dispozitat e cekura ligjore përcaktohet që Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit.

Nga të cekurat më lartë propozohet miratimi i këtij Propozim-Vendimi.

INr. 432/01-45702  
Lipjan më 12.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Ismir Ahmeti

